



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Nr. 336/prot.  
3

Tiranë, më 12.12.2024

**FTESË PËR NEGOCIATË**

**PËR**

**AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR PRODHIMIN  
PRODUKSIONEVE AUDIO VIZUALE**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1195, datë 05.08.2008, "Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore" ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" si dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike do të realizojë:

**Objekti:** "Prodhimin dhe transmetimin e një spoti ndërgjegjësues"

**Periudha e realizimit:** Realizimi i shërbimeve do të jetë 10 ditë nga kërkesat që do të vijnë AKSK sipas tematikës së kërkuar.

**Fondi limit i përcaktuar:** Fondi limit i procedurës ishte në vlerën është 1 599 722,22 lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Deri më 31/12/2024

**Publikimi i ftesës për negociata:** 12/12/2024

**Afati përfundimtar:** Për paraqitjen e konfirmimeve nga agjencitë e specializuara është më datë 19/12/2024.

**Konfirmimet për vazhdimin e negociatave:** Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit me objekt "**Prodhimin dhe transmetimin e një spoti ndërgjegjësues**" dhe jo përpara datës 19/12/2024 ora 16:00. Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

**Emri:** Autoriteti Kombëtar Për Sigurinë Kibernetike;

**Adresa:** Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë Shqipëri 04-22-21039;

**Gjuha për hartimin e ofertave është:** Shqip.

*Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Prodhimi i produksioneve audio vizuale", kriteret do të jenë si më poshtë.*

**Qëllimi i këtij shërbimi është:** Prodhimi i produksioneve audio vizuale me metrazh të shkurtër dhe të mesëm në funksion edukimin e studentëve dhe profesionistëve për sigurinë kibernetike, nënvizimin e angazhimit të AKSK-së dhe mbështetjes për zhvillimin e aftësive të nevojshme për të përballuar sfidat e kibernetikës, dhe për të nxitur pjesëmarrjen e institucioneve dhe individëve në programet e trajnimit.

## **I. SHËRBIMET QË KËRKOHEN TË REALIZOHEN:**

### **1. Objektivi i përgjithshëm:**

- Të theksohet rëndësia e arsimit profesional dhe përgatitjes së studentëve dhe profesionistëve të rinj për aftësitë praktike në sigurinë kibernetike.
- Të paraqitet roli i AKSK-së si investues dhe mbështetës në trajnimet profesionale dhe edukimin që ndihmon në zhvillimin e një force punëtore të aftë dhe të gatshme për sfidat kibernetike.
- Të përfshihet ideja e misionit kombëtar, duke nënvizuar se edukimi profesional në këtë fushë kontribuon në forcimin e sigurisë kombëtare.

### **2. Struktura e skriptit:**

- Hyrje (0-5 sekonda): Pamje të studentëve dhe profesionistëve të rinj që punojnë në ambiente moderne, laboratorë dhe klasa.
- Mesazhi kryesor (5-20 sekonda): Shfaqje e trajtimeve të ndryshme të AKSK-së, bashkëpunimet me shkollat profesionale dhe universitetet, dhe përfitimet e përgatitjes profesionale për karrierat e së ardhmes.
- Ftesa për veprim (20-30 sekonda): Një mesazh për të nxitur studentët dhe institucionet të marrin pjesë në këto programe për të përgatitur një të ardhme më të sigurt digjitale.
- Kohëzgjatja e spotit të jetë të paktën 30 sekonda.

### **3. Pamje vizuale:**

- Skena nga trajnimet: Studentët duke marrë pjesë në sesione trajnimi, duke përdorur teknologji moderne dhe duke bashkëpunuar me mentorë.
- Bashkëpunime: Pamje të diskutimeve midis AKSK-së dhe përfaqësuesve të universiteteve dhe shkollave profesionale.
- Angazhimi dhe suksesi: Momente që tregojnë studentët të diplomuar dhe të suksesshëm në fushat e tyre.

### **4. Elemente të misionit kombëtar:**

- Simbolika e zhvillimit kombëtar: Pamje të flamurit shqiptar ose simboleve që tregojnë përfitimin kombëtar nga edukimi profesional.
- Narracion që përmend përfitimin kombëtar: Theksi se edukimi profesional ndihmon në krijimin e një brezi që do të mbrojë dhe avancojë sigurinë e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit të vendit.

### **5. Narracioni:**

- Tonalitet entuziast dhe motivues: Përcjell ndjenjën e përkushtimit të AKSK-së për të mbështetur edukimin profesional dhe përgatitjen për sfidat dixhitale.
- Përmendje e misionit kombëtar: Një fjali e shkurtër që nënvizon përfitimin kombëtar si pasojë e zhvillimit të kapaciteteve.

#### 6. Muzika dhe audio:

- Muzikë dinamike dhe inspiruese: Për të krijuar ndjenjën e progresit dhe mundësive.
- Efekte audio për theksim: Për të përforcuar momente kyçe gjatë videos.

#### 7. Slogani për përfundimin:

Drejt një ekosistemi kibernetik të sigurt për Shqipërinë.

#### 8. Transmetimi i Spotit

Transmetimi i Spotit të bëhet në televizion publik dhe në të paktën dy televizione kombëtare.

## II. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

1. Është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
2. Nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
3. Nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me pikën 1 të nenit 76 të “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
4. Personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi perfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 76 të “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
5. Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
6. Nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 76 të “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
7. Ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomike, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. Nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
9. Ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
10. Kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

**Shënim:** Për plotësimin e kërkesave të mësipërme mund ti paraqesim më vetëdeklarim dhe përpara fazës së shpalljes së fituesit përfundimtar, shoqëria e renditur e para më pikë do të sjellë dokumentacionin provues.

### III.

#### KRITERET E VECANTA TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociata, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
  - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të turnzuara.
2. Oferta ekonomike: Operatorët do të duhen të paraqesin ofertën ekonomike të detajuar sipas 5 zërave të shërbimit të paraqitur më sipër në vlerën pa tvsh dhe me tvsh.
3. Operatorët ekonomik do të paraqesin një projekt ide/ zgjidhje teknike/ propozim për realizimin e shërbimeve që kërkohen.

#### A- KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ofertës ekonomike më të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- Kriteret e përgjithshme: 20 pikë
- Oferta financiare 50 pikë
- Zgjedhja teknike/propozimin për realizimin e shërbimit (projekt ideja) 30 pikë

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: [www.aksk.gov.al](http://www.aksk.gov.al)